



VENDIM

Nr.68 Datë 01.10.2009

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“HYDROENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjeshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HYDROENERGY” sh.p.k, për t`u liçensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**
- **Lejes së përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm-Erzen.**

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Lidhjen me sistemin **(neni 9, pika 4.1.5.a)** dhe lejen e mjedisit **(neni 9, pika 4.1.5.c)**, është shoqëruar nga informacioni se aplikuesi është ende në procesin e marrjes dhe miratimit të këtyre dy dokumenteve në institucionet përkatëse.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licensë të shoqërisë “HYDROENERGY” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi i Komisionerëve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.68 Datë 01.10.2009

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“HYDROENERGY” SH.P.K.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____